




KOMUNËS SË PRISHTINËS
DREJTORISË SË URBANIZMIT
Përshtet Drejtort të Uranizmit

PROPOZUESI: Lulzim (Bedrije) Latifi, nga Prishtina ,
Mati 1,Ruga."Shaqir Igrishta",banesat e"Fitorës"nr.191 ,hyrja 1,banesa nr.68,
Tel.044-124-325.

KUNDËRPROPOZUESI:N.P.T. "AGRO-TRADE". nr.biznesit-70205009,te pronarit Sadudin Humolli
Rruga "Rrustem Statovci " nr.62,Prishtinë.

Komentet sipas Njoftimit Publik të datës 26.08.2020,

Dhe

Kërkesë për ndërprerjen e punimeve të ndërtimit

LIDHJA JUAJ: Njoftimi Publik i datës 26.08.2020, sipas Kërkesa nr. 05-350/02-147459/20,
e datës 20.08.2020,të NPT "Agro Trade"

Konform nenit 13 të Urdhërësës Administrative të MMPH Nr,06/017,japim këto komente:

Kundërpropozuesi NPT "Agro- Trade" me kërkesën nr. 05-350/02-147459/20 të datës 20.08.2020, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit të caktohen kriteret për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa banimi dhe afariste, me etazhe ndërtimi në parcelat kadastrale nr. 668-0 dhe 669-1 Z.K. Matican, në kuadër të planit rregullues "Mati 1".

Drejtoria e Urbanizmit, duke vepruar sipas kërkesës së "Agro-Trade", ka bërë "Njoftimin Publik" sipas të cilit, nga qytetarët mund të jipen komente në lidhje me këtë propozim, të cilat mund të dorëzohen nga data 26.08.2020 deri me datën 09.09.2020, në e-mail adresën e urbanizmit: urbanizmi@prishtine.gov.net. Në njoftimin publik nën shtyllën "kushtet e propozuara të ndërtimit", nga pika a. deri në pikën n. askund nuk bëhet fjalë se aplikuesi i lejes për ndërtim ka të drejtë të fillojë punimet në qfarëdo forme qoftë, për derisa të zgjatë njoftimi publik dhe të ipet leja e ndërtimit.

Propozuesit kan kontest gjyqësor më kundërpropozuesin, për ngastrat kadastrale nr. 668-0 dhe 669-0(669-1),zk Prishtinë.

Kontesti gjyqësor nuk ka përfundue ende sepse , pas përfundimit të gjykimit në shkallën e parë dhe të dytë, propozuesit kanë paraqitë Revizion në Gjykatën Supreme. Kërkesa për revizion ende nuk është shqyrtue nga Gjykata Supreme.

Përkundër kësaj, kundërpropozuesi "Agro-Trade" në mënyrë arbitrare ka filluar punimet me datën 31.08.2020 në ato ngastra. Është filluar me "pilotim"-shpuarje vertikale dhe mbushje me beton-arme si dhe "injektim" mbushje horizontale me beton-arme.

Fillimi i këtyre punëve të ndërtimit, janë bërë pa kurrfarë leje nga organi kompetent i urbanizmit.

Propozuesit i kanë tërheqë vërejtjen kundërpropozuesit "Agro Trade" që të largohet nga posedimi, dhe mos të fillon kryerjen asnjë punim që ka të bëjë me ndërtimet e mëtejme në këto ngastra, para se të mirret leja e ndërtimit. Aj nuk i kan përfillë kërkesat e propozuesve duke shfaqur violencë, për të cilën gjë propozuesit kanë qenë të detyruar të kërkojnë ndërhyrjen e shërbimit të policisë.

Sherbimi Policor-Stacioni Jugu, nuk ka qenë në gjendje të ndërmerrë asnjë veprim. Nuk është marrë parasysh vërejtja jonë se "Agro Trade" ka hy në mënyrë arbitrare në posedim, pa leje ndërtimi apo leje të ngjashme pune, pa e përfillë procedurën e rregullt përmbartimore për lirim dhe dorëzim të palujtshmërisë, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, neni 39.265, 266 dhe 267; se kjo hyrje me dhunë në posedim të tokës kontestuese është veprim inkriminues dhe paraqet vepër penale të vetëgjyqësisë.

Sherbimi Policorë është mjaftue duke na kshilluar në vetëpërmbytje dhe duke na udhëzuar të drejtohem shërbimit të Inspeksionit të Ndërtimtarrisë.


Me datën 31.08.2020, me ftesën e inspeksionit kemi bërë kontaktimin dhe bisedën me dy zyrtarë të inspeksionit. Me atë rast nga inspektorët na është thënë se kanë biseduar edhe me palën tjetër dhe, sipas vlerësimit të tyre, nuk është detyrë e inspeksionit të ndërhyjë në këto raste për ndalimin e punëve fillestare të ndërtimit, se Agro-Trade e ka qartifikatën e pronës dhe i ka dy vendime të gjykatës.

Ne, kemi bërë konsultimin e dispozitave të Ligjit për Urbanizëm, Urdhëzimin administrativ të MMPH, dhe kemi kuptuar se "Agro Trade" si aplikues për leje ndërtimi, nuk mund të kryej asnjë punë në terren para se të përcaktohen kushtet urbanistike dhe të ipet leja e ndërtimit; se "Pilotimi" apo shpurja vertikale dhe mbushja me beton-arme, si dhe "Injektimi" horizontal dhe mbushja me beton-arme, të cilën punë e ka filluar dhe ka për qëllim ta kryej aplikuesi para marrjes së lejes së ndërtimit, nuk mund të bëhet pa leje përkatëse të Organit kompetent të Urbanizmit.

Andaj, ju lutem shumë për ndihmën tuaj ligjore, që me urgjencë ta shqyrtoni dhe ta merrni parasysh këtë kërkesë tonen, dhe në bashkpunim me inspeksionin kompetent të ndërmarrni masat e duhura, të bëni më dija aplikuesit të lejes së ndërtimit "Agro Trade" të ndërprejë punimet e tilla të filluar në ngastrat nr. 668-0 dhe 669-1 Z.K. Prishtinë, dhe të përmbahet derisa të lëshohet leja e ndërtimit dhe të përfundon procedura gjyqësore në lëndën C.nr1247/16, e cila procedurë është në fazën e Revizionit. Në këtë mënyrë të zbatohet drejtësia dhe të eliminohet dhuna e arbitrarizmi.

Në Prishtinë, më 07.09.2020.

Propozuesi Lulzim (Bedrije) Latifi,



044-124 325